

Në bazë të nenit 13 paragrafi 2 të Ligjit mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve (“Fleta zyrtare e RMZ” nr. 4/98, 5/98, 17/98, 14/00, 18/00, 9/01, 41/02, 46/02, 45/04, 48/06 dhe “Fleta zyrtare e MZ”, nr 46/11, 14/14, 47/14, 12/16, 060/17 dhe 010/18) Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit përcakton dhe publikon

## **KALENDARIN**

### **E AFATEVE PËR ZBATIMIN E VEPRIMEVE ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLTARËVE NË KUVENDIN E KOMUNËS SË TUZIT TË CILAT DO TË MBAHEN MË 03.03.2019**

Organi kompetent i transmetuesve publik dhe transmetuesve komercial dhe jofitimprurës janë të obliguar të sjellin dhe të bëjnë publikut të afrueshme rregullat me të cilat rregullohet përfaqësimi i parashtruesve të listave zgjedhore më së largu në afat prej 10 ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.

**Afati: 10.12.2018 deri në orën 24:00.**

Partitë politike të regjistruara në Mal të Zi, koalicioni i partive politike ose grup votuesish të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje për zgjedhjen e këshilltarëve në Kuvendin e Komunës së Tuzit dorëzojnë Komisionit komunal zgjedhor të Tuzit listën zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve në Kuvendin e Komunës së Tuzit jo më herët se 20 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.

**Afati: 20.12.2018**

kurse më së largu 25 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

**Afati: 05.02.2019 deri në orën 24:00.**

Vendimi mbi numrin e duhur të nënshkrimeve të votuesve për mbështetje listës zgjedhore.

Parashtruesi i listës zgjedhore të konfirmuar do të përcaktojë përfaqësuesin e vet të autorizuar në përbërje të zgjeruar të Komisionit komunal zgjedhor të cilët mund të marrin pjesë dhe në mënyrë të vlefshme të vendosin 20 ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

**Afati: 10.02.2019**

Parashtruesi i listës zgjedhore do të përcaktojë përfaqësuesin e vet të autorizuar në përbërje të zgjeruar të këshillit zgjedhor, i cili mund të marrin pjesë në punë dhe në mënyrë të vlefshme të vendosin pesë ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

**Afati: 25.02.2019 deri në orën 24:00.**

Vendvotimet përcakton Komisioni komunal zgjedhor në propozim të organit kompetent për udhëheqjen e listës së votuesve më së largu 20 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

**Afati: 10.02.2019 deri në orën 24:00.**

Komisioni komunal zgjedhor 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve është i obliguar të sjell aktvendimin me të cilin partitë politike kanë të drejtë të propozojnë përfaqësuesit në përbërje të përhershme të këshillit zgjedhor.

Aktvendimi u dorëzohet të gjithë parashtresve të listave zgjedhore të konfirmuara në afat prej 24 orëve nga dita e sjelljes.

**Afati: 15.02.2019 deri në orën 24:00.**

Konkludimin mbi eliminimin e mangësive të listës zgjedhore- afati 48 orë pas pranimit të listës zgjedhore- afati për eliminimin e mangësive 48 orë pas pranimit të Konkludimit.

Aktvendimi mbi refuzimin e listës zgjedhore kur nuk janë të eliminuara mangësitë- afati 24 orë nga afati për korrigjimin e mangësive.

Aktvendimi mbi shpalljen e listës zgjedhore e cila nuk ka mangësi ose mangësitë janë eliminuar- afati menjëherë pa vonesë u dorëzohet parashtresve të listës.

Në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve në programet e shërbimeve të radiotransmetimit dhe medimeve të tjera nuk është e lejuar publikimi i rezultateve të sondazheve të opinionit publik, hulumtimeve të tjera dhe analizave në lidhje me orientimin e votuesve në drejtim të vlerësimit të rezultateve të zgjedhjeve.

**Afati: 15.02.2019**

Renditjen në listën përfundimtare zgjedhore e përcakton kryetari i komisionit zgjedhor nëpërmjet hedhjes së shortit, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të parashtresve të listave zgjedhore të konfirmuara.

**Afati: pas konfirmimit të listave zgjedhore**

Komisioni komunal zgjedhor listën përfundimtare zgjedhore e publikon më së largu 15 ditë nga dita e përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

**Afati: 15.02.2019 deri në orën 24:00.**

Këshilli zgjedhor emërohet për çdo vendvotim më së largu 10 ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

**Afati: 20.02.2019 deri në orën 24:00.**

Komisioni komunal zgjedhor më së largu 10 dit para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve njofton se cilat vendvotime janë të përcaktuara dhe cilët votues do të votojnë në vendvotimet e caktuara.

**Afati: 20.02.2019 deri në orën 24:00.**

Vëzhguesit e huaj të interesuar, paraqitjen për vëzhgim të zgjedhjeve parashtrojnë Ministrisë së punëve të jashtme të Malit të Zi, më së largu 10 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

**Afati: 20.02.2019 deri në orën 24:00.**

Organizatrat joqeveritare vendase të interesuara për ndjekjen e zgjedhjeve parashtrojnë paraqitjen Komisionit shtetërorë zgjedhor, më së largu 5 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

**Afati: 25.02.2019 deri në orën 24:00.**

Materialin zgjedhor nga Komisioni komunal zgjedhor merr kryetari i këshillit zgjedhor më së largu 48 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

**Afati: 28.02.2019 deri në orën 24:00.**

Propaganda zgjedhore përmes medimeve dhe tubimeve publike gjegjësisht e drejta e mbulimit mediatik në kampanjën parazgjedhore ndalohet 24 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

**Afati: 01.03.2019 deri në orën 24:00.**

Me përcaktimin e rezultateve të zgjedhjeve, e më së largu në afat prej 6 orësh nga ora e mbylljes së vendvotimit, këshilli zgjedhor pa vonesë do të dorëzojë komisionit komunal zgjedhor materialin zgjedhor.

**Afati: 04.03.2019 deri në orën 02:00.**

Në bazë të rezultateve të votimeve në të gjitha vendvotimet në njësinë zgjedhore, Komisioni komunal zgjedhor përcakton rezultatet e përkohshme të zgjedhjeve për zgjedhjen e këshilltarëve, në afat prej 12 orësh nga ora e dorëzimit të raportit nga vendvotimet.

**Afati: 04.03.2019 deri në orën 14:00.**

Komisioni komunal zgjedhor përcakton rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për këshilltarë në afat prej 12 orësh nga skadimi i afatit për dorëzimin e parashtresave, gjegjësisht ankesave, gjegjësisht nga përfundimi ose zbatueshmëria e vendimeve të sjella sipas parashtresave apo ankesave.

Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për këshilltarë publikohen në “Fletën zyrtare të Malit të Zi-dispozitat komunale”, më së largu në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

**Afati: 18.03.2019 deri në orën 24:00.**

Ministria kompetente për listat zgjedhore dorëzon votuesve njoftim mbi zgjedhje, më së largu shtatë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

**Afati: 23.02.2019 deri në orën 24:00.**

Ministria kompetente për listat zgjedhore, për nevojat e identifikimit elektronik të votuesve , në vendvotim, bën versionin elektronik të ekstrakteve nga listat zgjedhore për çdo vend në mediumet elektronike përkatëse në afat prej 72 orësh nga dita e sjelljes së aktvendimit mbi përmbylljen e listave zgjedhore.

**Afati: 23.02.2019 deri në orën 24:00.**

Ministria e punëve të brendshme në afat prej 48 orësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve publikon në të gjitha gazetat ditore të cilat publikohen në Mal të Zi dhe në internet faqen e vet tabelën numerike të të dhënave mbi ndryshimet e rezultuara në listën zgjedhore në përgjithësi dhe sipas njësive të vetëqeverisjes lokale në krahasim me listën zgjedhore sipas së cilës janë mbajtur zgjedhjet paraprake në nivelin shtetëror.

**Afati: 02.12.2018 deri në orën 24:00.**

Në afat prej 3 ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve Ministria e punëve të brendshme përmes mjeteve të informimit publik dhe në internet faqen e vet njofton se po publikon listën zgjedhore gjegjësisht pjesën e listës zgjedhore për njësinë e vetëqeverisjes lokale për të cilën janë shpallë zgjedhjet në dispozicion të votuesve dhe njofton votuesit mbi kohën dhe mënyrën e shqyrtimit dhe mundësinë për të kërkuar ndryshimin e të dhënave të futura në listën zgjedhore.

**Afati: 03.12.2018 deri në orën 24:00.**

Ministria e punëve të brendshme me aktvendim përmbyllë listën zgjedhore 10 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

**Afati: 20.02.2019 deri në orën 24:00.**

Ministria e punëve të brendshme në afat prej 48 orësh nga dita e përmbylljes përfundimtare të listës zgjedhore, publikon në të gjitha gazetat ditore të cilat publikohen në Mal të Zi dhe në internet faqen e vet tabelën numerike të të dhënave mbi ndryshimet e rezultuara në listat zgjedhore në përgjithësi dhe sipas njësive të vetëqeverisjes lokale mbi votuesit të cilët kanë fituar të drejtën elektorale dhe bazën e arritjes së kësaj të drejte, si dhe të dhënat mbi personat të cilët kanë humbur të drejtën elektorale dhe bazën e humbjes së kësaj të drejte.

**KOMISIONI KOMUNAL ZGJEDHOR**

**KRYETARI**

**Shtjefën Ujkiq**